

LIVRET D'ACCUEIL AU COLLEGE AU LYCEE

FRANÇAIS/ALBANAIS

Libërth prezantues për KOLEGJI GJIMNAZI

Ce livret est destiné aux élèves nouvellement arrivés en France et à leurs parents.

Ky libërth është i nevojshëm për fëmijët dhe prindërit e sapoardhur në Francë.

Shkolla është laike, falas dhe e obliguar për të gjithë fëmijët që banojnë në territorin francezë prej moshës 6 vjeçare deri në moshën 16 vjeçare.
Shkollimi është një e drejt dhe gjithashtu një obligim. Fëmiju juaj duhet pra me përcjellur shkollimin në mënyrë të .

Në bazë të dispozitave ligjore të artikullit L.141-5-1 mbi kodin e edukimit « nxënësit që mbajnë shenja apo veshin tesha për të manifestuar haptazi përkatësin fetare është e ndaluar ». Në rast se ndonjë nxënës nuk e respekton këtë ndalim, drejtoresha apo drejtori do të mbledhë ekipin edukativë (artikulli 21 i dekretit n°90.788 të 06/09/1990) për të organizuar një dialog me nxënësin dhe familjen e ti.

Punim i realizuar së bashku me përgjegjësen e misionit për pritjen e nxënësve të posaardhur në Francë (ENAF) dhe shërbimi për aksione sociale në përkrahje të nxënësve në inspeksionin akademik të Ain

KOLEGJI NË FRANCË	2
1 - Cilat janë etapat e ndyshme të shkollimit në Francë?	2
2 - Si funksionon kolegji?	3
Si organizohet shkollimi në kolegji?.....	3
Klasat e ndyshme.....	3
Shkollimi i përgjithshëm i adaptuar (SEGPA).....	4
Dispozitivet për pritjen e nxënësve që nuk e flasin gjuhën frenge .	4
Kë duheni të takoni në kolegji?	5
Drejtori i shkollës (apo shefi i qendrës)	5
Drejtori i shkollimit të përgjithshëm të adaptuar SEGPA	5
Ndihmësi i Drejtorit.....	5
Këshilltari kryesor i edukimit.....	5
Kujdestari i klasës.....	5
Arkatar	5
Asistenca sociale	5
Infermierja	5
Këshilltari i orjentimit psikologu.....	5
Prindërit e nxënësve.....	5
Organizimi i jetës në kolegji.....	5
Orët e mësimit dhe rregullorja	5
Jeta në shkollë	6
Ndihmat për mësim	6
Komunikimi me shkrim me kolegjin.....	6
Libreza e letërkëmbimit	6
Dëftesat e fund vitit	6
Këshillet dhe mbledhjet	6
Këshilli i klasës	6
Mbledhja mes prindërve dhe profesorëve	6
Këshilli i Administrimit	6
Këshilli i Disiplinës	6
Formalitetet administrative.....	7
Ndihmat financiare	7
Bursat, në bazë të të ardhunave.....	7
Fondi social	7
GJIMNAZI NË FRANCË	7
Adresat e nevojshme:	8

KOLEGJI NË FRANCË

Shkolla është laike, falas dhe e obliguar për të gjithë fëmijët që banojnë në territorin francezë prej moshës 6 vjeçare deri në moshën 16 vjeçare.
Shkollimi është një e drejt dhe gjithashtu një obligim. Fëmiju juaj duhet pra me përcjellur shkollimin në mënyrë të rregullt.


1 - Cilat janë etapat e ndyshme të shkollimit në Francë?

Fëmiju juaj mundet të fillon shkollimin në kopshtin e fëmijëve ose shkollimi parashkollor nga mosha 2 vjeçare. Në moshën 6 vjeçare, ai duhet të fillon shkollimin fillor që do ta përgaditë për shkollimin në kolegji.

Në moshën 11 vjeçare, ai duhet të fillon shkollimin katër vjeçarë në kolegji. Kolegji i përgadit fëmijët për studimet e mesme (në lice) në degat e përgjithshme ose teknologjike ose në shkollimin e mesëm profesional (lice profesional ose në Qendrat e Mësimit për Zanat (CFA).

Në shkollimin e mesëm (në lice) që zgjatë tri vite, ai do të përgadisë shkollën e mesme të përgjithshme ose teknologjike që do ti mundësoj të marrë diplomën e pjekuris (maturës) dhe ti vazhdojë studimet e larta (studime të shkurta apo të gjata).

Në shkollimin e mesëm profesional ose në qendrat e mësimit për zanat, fëmiju juaj do të përgadisë certifikatën për aftësi profesionale (CAP) ose certifikatën apo diplomën e shkollimit profesional (BEP) dhe mandej nëse dëshiron ai mundet të marrë diplomën e pjekuris profesionale (maturën profesionale).



Një shkollim i arritur është gjithashtu punë e familjes. Sa më shumë që ju do ta inkurajoni atë më mirë ai do të arrijë të ketë rezultate të mira.

2 - Si funksionon kolegji?

Në moshën 11 vjeçare, fëmiju juaj do të hyjë në kolegji. Mësimi në kolegji do të zgjatë katër vite. Në ndryshim prej shkollës fillore, profesorët në kolegji janë të ndryshëm në çdo lëndë. Të gjitha lëndët janë të obliguara. Në fund të katër viteve shkollë, diploma nacionale për 8-vjecaren dhe certifikata e formimit të përgjithshëm (CFG) për Segpa, njohin nivelin shkollor të arritur prej këtyre fëmijëve..

Si organizohet shkollimi në kolegji?

Klasat e ndryshme

Në klasën e 6 dhe posaçërisht gjatë javëve të para të vitit shkollor, profesorët do t'ju ndihmojnë fëmijut tuaj që të njohë më mirë kolegjin dhe të kuptojë se si duhet të punojë ai. Për shembull është shumë me rëndësi që të organizoni mësimin në shtëpi që është e domosdoshme për arritjen e ti në shkollë.

Lëndët e mësuara janë:

- gjuha frenge
- matematika
- një gjuhë tjetër e huaj
- histori – gjeografi – edukimi i të drejtave qytetare
- shkenca dhe jeta e tokës
- teknologji
- mësimet artistike

edukimi fizik e sportiv orët e mësimit janë të obligueshme për vajzat dhe për djemtë. Mësimi është i përbashkët por salla e ndërrimit është e ndarë. Duhet të kenë veshmbathjen e duhur: trinerkat, basketet, bekinet dhe kapelën e pishinës. Në rast se kenë ndonjë pengesë mjekësore, atëherë, ju duheni të na sjellni certifikatën e mjekut. Certifikata është e obliguar.

Në klasën e 5, të 4 dhe të 3 ai do të mësoj lëndë të reja. Fëmiju juaj duhet ti zgjedhë lëndët që do ti mësoj dhe për këtë arsye ju duheni të jeni shumë të kujdesshëm në zgjedhjen e këtyre lëndëve të reja .

Nxënësit që kanë vështirësi munden të kenë një ndihmë të veçant. Këshilli i klasës vendosë për kalimin në klasën e lartë apo të përsërit vitin. Në rast se familja nuk është e kënaqur me vendimin e këshillit të klasës, ajo mundet të bëjë thirrje mbasi të takoj drejtorin e kolegjit.

Në fund të vitit të 3, fëmiju juaj duhet të zgjedhë mes studimeve të përgjithshme, teknologjike ose profesionale. Ai mundet gjithashtu të zgjedhë mësimin në qendrat për zanat ku do të mund të përgadis çertifikatën për aftësi profesionale (CAP) ose çertifikatën apo diplomën e shkollimit profesional (BEP). Është ekipi pedagogjik që vendos mbasi ti ketë marrë dëshirat e juaja.

Të keni kujdes sepse në disa drejtime të shkollave të mesme, pranimi i nxënësve bëhet me dosje dhe me data të caktuara për arsye se vendet janë të kufizuara. Pra ju duheni ti respektoni veprimet që kolegji do t'ju informoj dhe mos ngurroni të takoheni me Këshilltarin e Orjentimit Psikologun.

Shkollimi i përgjithshëm i adaptuar (SEGPA)

Nxënësit që kanë vështirësi të mëdha në mësim munden të përcjellin shkollimet e përgjithshme të adaptuara (SEGPA).

Numri i nxënësve në këto klasa është më i vogël (16 nxënës). Lëndët e mësuara do të udhëheqën nga profesor të kolegjit (gjuhë e huaj, historia-geografia, shkencat, teknologjia, ...) dhe nga mësues të specializuar.

Nxënësit që përcjellin një shkollim të adaptuar do të marrin pjesë si të gjithë nxënësit e tjerë në jetën e shkollës dhe në aktivitetet e përgjithshme të kolegjit : CDI, klubet, qendrat socio-edukative, shoqatat sportive, punimet e deleguara, aksionet educative ...

Nga klasa e 4-ërt, nxënësit që përcjellin shkollimin e përgjithshëm të adaptuar (SEGPA) do të njoftohen me mjedise të ndryshme profesionale :

- në orët praktike që do të organizohen në ateljet e SEGPA-ës
- në praktikën që do të organizohet gjatë vitit në firma të ndryshme.

Në fund të katër viteve të shkollimit, Çertifikata e shkollimit të përgjithshëm (CFG) do t'ju njehtë **nivelin e shkollimit të arritur**.

Objektivi : të keni në minimum një diplomë të nivelit V (C.A.P) në gjimnaz profesional, në kontratë të mësimit (zanatit), në shtëpin familjare apo në fshat.

Dispozitivët për pritjen e nxënësve që nuk e flasin gjuhën frengje

Nëse fëmiju juaj nuk e flet mirë gjuhën frengje, ai mundet të përcjellë dispozitivin për mësimin e gjuhës frengje pa e ndërprerë mësimin në klasën e përgjithshme të nivelit të tij.

Për të vlerësuar nivelin e tij në gjuhën frengje, ai mundet të marrë diplomën për mësimin e gjuhës frengje (DELF shkollor)

Kë duheni të takoni në kolegji?

Edhe nëse keni vështirësi në gjuhën frenge, mos ngurroni të takoheni me personelin e kolegjit ; ata do të gjejnë një zgjedhje për t'ju mundësuar që të komunikoni me ta.

Drejtori i shkollës (apo shefi i qendrës)

Përgjegjësi i shkollës është pra drejtori i kolegjit. Ai është përgjegjës për çdogjë që ndodh në shkollën e ti : ndarjen e orëve të mësimit, diciplinën, orjentimin. Ju mundeni ta takoni kur të doni vetëm se duhet të merrni takim me të.

Drejtori i shkollimit të përgjithshëm të adaptuar SEGPA

Ai ka të njejtat funksione apo përgjegjësi si çdo drejtor tjetër i kolegjit

Ndihmësi i Drejtorit

Ai i ndihmon drejtorit me udhëheq kolegjin.

Këshilltari kryesor i edukimit

Ai organizon dhe mbikqyr jetën e përditshme në kolegji (vonimet, mungesat, dhe sjelljet apo diciplinën e nxënësve në shkollë dhe në kopsht të shkollës ...). Ai kujdeset gjithashtu për problemet në mes të nxënësve. Ati i ndihmon mbikqyrësit e shkollës. Ajo mund të ketë ndihmën nga asistentët e edukimit.

Kujdestari i klasës

Ai është përgjegjës i klasës ku gjindet fëmiju juaj. Ai është bashkëbiseduesi juaj për orjentimin. Ju duheni të takoheni me të nëse doni të dini se si mëson fëmiju juaj në kolegji. Ju mundeni gjithashtu të takoni profesorët tjerë nëse fëmiju juaj ka vështirësi në ndonjë lëndë.

Arkatari

Ai kujdeset për mensën dhe bursat.

Asistenca sociale

Ajo mundet të ju këshillojë dhe të ju ndihmojë në zgjedhjen e problemeve familjare, financiare apo administrative. Ajo ju ndëgjon dhe takohet me fëmijun e juaj.

Infermierja

Ajo i informon nxënësit në lidhje me problemet shëndetësore dhe mundet të jepë ndihmën e parë në rast aksidenti në kolegji.

Këshilltari i orjentimit psikologu

Ai do t'ju ndihmojë juve dhe fëmijut tuaj në zgjedhjen e shkollimit dhe për të ardhmën profesionale të fëmijut tuaj. Ju mundeni ta takoni me takim në kolegji apo në qendrën e informimit dhe orjentimit (CIO).

Prindërit e nxënësve

Prindërit e nxënësve e kanë një rolë aktiv dhe të rëndësishëm në jetën e kolegjit. Në fillim të çdo viti shkollor, prindërit do të zgjedhin përfaqësuesit e tyre që do të marrin pjesë në këshillin administrativ të kolegjit. Delegatët e prindërve do të marrin pjesë në këshillin e klasës. Ata do të jenë përfaqësuesit e të gjithë prindërve dhe ata do të paraqesin kërkesat e prindërve.

Organizimi i jetës në kolegji

Orët e mësimit dhe rregullorja

Orari i mësimit caktohet për çdo klasë në fillim të vitit shkollor. Aty do të caktohet orari i fillimit të mësimit dhe mbarimit. Poashtu edhe orarin e orëve të mësimit për tërë javën e mësimit.

Rregullorja përcaktohet në çdo kolegji dhe komunikohet me shkrim të gjithë nxënësve dhe prindërve në fillim të vitit shkollor në kolegji. Në rregullore precizohet se pjesëmarrja në orët e mësimi është e obliguar për çdo nxënës, që nxënësi nuk duhet të mungoj (vetëm kur është i sëmur) dhe nuk duhet të vonohet në orët e mësimi. Poashtu nxënësi duhet të respektoj çdo njeri në kolegji dhe lokalet e kolegjit. Nxënësi duhet të jetë i qetë gjatë orëve të mësimi dhe duhet të mësoj rregullisht në shkollë dhe në shtëpi.

Nëse mungon, ju duheni të lajmëroni kolegjin me telefon dhe ti shkruani një letër shkollës ku i tregoni arsyejen e mungesës së tij. Në rast se fëmiju juaj është i sëmur, ai duhet të rri në shtëpi dhe kur të kthehet në shkollë duhet ta paraqes certifikatën e mjekut.

Jeta në shkollë

Përveçse orëve të mësimi, aktivitete tjera mund të propozohen nxënësve (klubet, sporti,)

Ndihmat për mësim

Në kolegji, në rast se keni vështirësi të veçanta, ndihma të veçanta propozohen në bazë të shoqërimit edukativ. Jashtë shkollës, Qendrat sociale propozojnë ndihmë për detyrat. Ju mundeni të informoheni në qendra sociale.

Komunikimi me shkrim me kolegjin

Librezat e letërkëmbimit

Kjo librezë është një lidhje mes jush dhe personelit të kolegjit. Mungesat dhe vonimet e nxënësve do të shkruhen në këtë librezë dhe poashtu mungesat e profesorëve apo ndërimit i orëve të mësimi. Nxënësi duhet të shkruaj notat e veta. Kjo librezë ju mundëson të shkruani kur fëmiju juaj mungon dhe poashtu të kërkonit takim me kujdestarin e klasës apo me dikë tjetër në kolegji. Profesorët do të shkruajnë nëse fëmiju juaj ka vështirësi apo nëse silltet keq në shkollë dhe poashtu denimet që ai mundet të ketë. Kjo librezë ju mundëson që ju të përcillni shkollimin dhe sjelljet e fëmijut tuaj. Ajo duhet të firmoset rregullisht.

Dëftesat e fund vitit

Dëftesat e fund vitit do të merrni në shtëpi mbasi të mbahet këshilli i klasës. Aty do të shkruhen notat mesatare të fëmijut tuaj dhe poashtu vlerësimin e çdo profesorit në çdo lëndë.

Këshillet dhe mbledhjet

Këshilli i klasës

Këshilli i klasës mbledhet tri herë në vit. Aty marrin pjesë të gjithë profesorët dhe kujdestari i klasës (apo ndihmësi i kujdestarit). Ata i shikojnë rezultatet e çdo nxënësi. Poashtu vendosin për orjentimin e nxënësit. Në këshillin e klasës marrin pjesë edhe dy delegat të nxënësve dhe dy delegat të prindërve.

Mbledhja mes prindërve dhe profesorëve

Kjo mbledhje ju mundëson të takoheni me çdo profesor të fëmijut tuaj dhe të bisedoni me të në lidhje me punën, sjelljen dhe mësimin e tij. Në interesin e fëmijut tuaj, ju duheni të mirrni pjesë në këto mbledhje. Ju mund ta përdorni për përkthim në rast se keni nevojë.

Këshilli i Administrimit

Ky këshill vendos për organizimin e kolegjit : rregulloren e mbrendshme, buxhetin dhe organizimin pedagogjik.

Këshilli i Disiplinës

Ky këshill mbledhet kur një nxënës nuk e ka respektuar rregulloren e mbrendshme të kolegjit dhe ka bërë ndonjë gabim të madhë. Ky këshill mundet të vendos të përjashtoj për disa ditë fëmijun e juaj nga kolegji apo t'ja ndërroj shkollën.

Formalitetet administrative

Të gjitha dokumentat administrative që ju duheni ti sjellni në lidhje me regjistrimin, fletoret, librat shkollore, sigurimi shkollor i obliguar, karta e transportit, do t'ju komunikohet para fillimit të vitit shkollor
Transporti shkollor është falas në rrethin e Ain.

Sigurimi shkollor: një sigurim për përgjegjësi civile ju nevojitet në momentin e regjistrimit të fëmiut tuaj. Ky sigurim është i detyruar. Është me rëndësi që fëmiu juaj të jetë i siguruar për dëmet që mundën ti ndodhin apo që mundet ti shkaktojë.

Për më shumë informata, ju mundeni të kontaktoni Drejtorin e Shkollës.

Ndihmat financiare

Bursat, në bazë të të ardhunave

Bursa e kolegjit ipet nga klasa e 6^{-të} deri te klasa e 3^{-të}. Kërkesa duhet të bëhet çdo vitë në muajin shtator.

Bursa e departamentit ipet në klasën e 4^{-ërt}. Kërkesa duhet të bëhet gjatë muajit janar në klasën e 5^{-të}.

Kërkesa për bursën kombëtare për gjimnaz duhet të bëhet gjatë muajit janarë në klasën e 3^{-të}.

Të gjitha këto informata do t'ju ipen me shkrim në karnetin e korrespondencës.

Mos harroni të bëni kërkesat. Për të gjitha informatat, ju mundeni të drejtoheni tek sekretariati i kolegjit.

Fondi social

Në rast vështirësie financiare, një ndihmë mundet t'ju ipet për pagesën e menzës apo udhëtimeve apo daljeve shkollore.

Për të gjitha informatat, ju mundeni të drejtoheni tek sekretariati i kolegjit.

GJIMNAZI NË FRANCË

Shkolla është laike, falazi dhe e detyrueshme për të gjithë fëmijët që jetojnë në teritorin francezë nga mosha 6 vjeçare deri në moshën 16 vjeçare.
Shkollimi është një e drejtë. Poashtu është edhe e detyrueshme. Fëmiu juaj duhet të shkojë në shkollë.

Mbas kryerjes të kolegjit, fëmiu juaj mundet :

- ti vazhdojë studimet në gjimnaz,
- të fillojë një shkollim profesional për të përgaditur diplomën CAP:


të shkojë në gjimnaz profesional

të shkojë në zanat (tek një punëdhënës dhe në qendrën e mësimit për zanat (CFA))


Në gjimnaz, mbas tri viteve ; nxënësit duhen ta kryejnë maturën (« bac » shkurtimisht)

Adresat e nevojshme:

Matura e përgjithsme	Matura teknologjike
L	STI2D
S	STL
ES	STD2A
	STG
	ST2S
2 (dy)	



Në gjimnazin profesional ose apo në qendrat e mësimit për zanat (C.F.A.)



Insepksioni Adamemik Zyra për Pritjen e Personave që Arrinë në rrethin tonë të Ain C.R.I. (kurset për mësim të integruar)
5, rue La Fontaine
01000 Bourg-en-Bresse
☎: 04 74 21 99 54
ce.ia01-enaf@ac-lyon.fr

Dispozitivi i pritjes për nxënësit e posaardhur në Oyonnax (DIAPASO)
Kolegji Jean Rostand
Rruga Marcel Gaget Marchon numër 5
01100 Arbent
☎ : 04.74.77.15.79
enaf.0010065r@ac-lyon.fr